



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA URA VAJGURE

Nr 764 Prot

Urë Vajgurore 02/03/2021

TERMA REFERENCE

Pozicioni: Ekspert psikolog për ofrimin e shërbimeve psikologjike (terapi individuale & në grup) në kuadër të projektit *“Krijimi i mekanizmit të reagimit të koordinuar (MKR) për adresimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në Bashkinë e Ura Vajgurore”*

Periudha e kontratës: mars-dhjetor 2021

Në kuadër të projektit *“Krijimi i mekanizmit të reagimit të koordinuar (MKR) për adresimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në Bashkinë e Ura Vajgurore”* i cili po implementohet nga Bashkia Ura Vajgurore me mbështetjen e UNDP Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara *“T’i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri”*, financuar nga Qeveria e Suedisë dhe zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA, Bashkia Ura Vajgurore po kërkon të punësojë një ekspert psikolog për të ofruar shërbime mbështetëse psikologjike (terapi individuale dhe në grup) për viktimat e dhunës në familje.

Përshkrimi i projektit:

Bashkia Ura Vajgurore po zbaton projektin *“Krijimi i mekanizmit të reagimit të koordinuar (MKR) për adresimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në Bashkinë e Ura Vajgurore”* me mbështetjen e UNDP Shqipëri, në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara *“T’i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri”*, financuar nga Qeveria e Suedisë dhe zbatohet nga UNDP, UN Women dhe UNFPA. Projekti ka si qëllim të kontribuoj në ngritjen dhe fuqizimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) kundër dhunës në familje në Bashkinë e Ura Vajgurore për një adresim më të mirë të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Aktivitetet kryesore të projektit janë: 1) Mbështetje për krijimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit nëpërmjet takimeve të ETN dhe Komitetit Drejtues. 2) Aktivitetet të mbështetjes emergjente të rasteve të dhunës në familje (pako ushqimore, mbështetje psikologjike dhe ligjore për rastet); 3) Aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve; 4) Aktivitete për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut me një fokus të veçantë të rinjtë dhe komunitetet e zonave rurale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA URA VAJGURE

Përgjegjësitë:

Expertja do të bashkëpunojë ngushtësisht me strukturën e shërbimeve sociale në Bashkinë Ura Vajgurore - Koordinatorën vendor të dhunës në familje dhe antarët e MKR/ETN për ofrimin e shërbimeve sipas nevojave të rasteve të identifikuara.

Ekspertja do të jetë përgjegjëse për:

- Të ofrojë mbështetje psikologjike për rastet e identifikuara nga Mekanizimi i Koordinuar i Referimit viktime të dhunës në familje dhe në bashkëpunim të ngushtë me Koordinatorën vendorë;
- Të ofrojë seanca individuale/në grup këshillimi sipas nevojave të identifikuara nga Koordinatorja Vendore e dhunës në familje dhe antarët e MKR.
- Të përgatisi raporte vlerësimi për në gjykatë për rastet e dhunës që do të menaxhohen nga MKR sipas nevojave (raport vlerësimi psikologjik për UMM/UM, kujdestari, etj)
- Të përgatisi raporte mbi progresin e rasteve të trajtuara dhe tia vëri në dispozicion bashkisë sipas kërkesave të kësaj të fundit.

Kualifikimet dhe eksperiencia e punës:

- Diplomë universitare në Psikologji/Punë Sociale me specializim në Këshillim, ndërthurur me trajnime të specializuara në fushën e psikologjisë;
- Eksperinca të mëparshme në ofrimin e shërbimeve të mbështetjes psiko-emocionale për fuqizimin dhe integrimin e rasteve;
- Njohuri shumë të mira rreth situatës së trajtimit të viktimeve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në Shqipëri;
- Të jetë i/e regjistruar pranë Urdhërit të Psikologut (e preferueshme);
- Aftësi në monitorimin, vlerësimin dhe analizën e situatës së rasteve të trajtuara;
- Aftësi shumë të mira komunikuese dhe menaxhimit të situatave të ndryshme;
- Aftësi për të punuar në grupe multidisiplinare.

Procedura e Aplikimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA URA VAJGURE

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për këtë pozicion duhet të dërgojnë pranë zyrës së burimeve njerëzore në Bashkinë Ura Vajgurore CV-në e tyre, një letër interesi drejtuar Bashkisë Ura Vajgurore deri në datën **17 mars 2021, ora 16:00.**

Bashkia Ura Vajgurore do të kontaktojë vetëm aplikantët e përzgjedhur për fazën e intervistës për punësim.